



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019), nenit 36 paragrafi 1, nenin 40 dhe neni 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), duke vepruar për denoncimin për korrupsion nga parashtrues i panjohur, në vazhdimin e seancës së 46-të të mbajtur me datë 19 shkurt 2021 morri

VENDIM

Procedura e ngritur pas denoncimit për korrupsion nr. 12-5484/1 me datë 03.12.2019 dorëzuar nga parashtrues i panjohur, **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka bazë për veprim të mëtutjeshëm kompetent në lëndën me numër 12-5484 nga viti 2019 e formuar në bazë të denoncimit nr. 12-5484/1 me datë 03.12.2019.

Lënda me numër 12-5484 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

SQARIM

Lënda me numër 12-5484 nga viti 2019 është formuar në bazë të denoncimit nr. 12-5484/1 me datë 03.12.2019, dorëzuar nga parashtrues i panjohur.

Me akuzat në denoncim flitet për dyshime për punë të pakujdesshme në shërbim nga personat zyrtarë gjatë emërimit të ekzekutorëve në vendin e punës – Sekretar në në mënyrë në pozicionin e përmendur është/ka qenë emëruar person në lidhje me të cilën nuk është/është vlerësuar në mënyrë të rregullt sipas kushteve të parapara të cilat duhen t'i plotësojnë ekzekutorët për kryerje të punës në vendin e punës Sekretar në

Ashtu që, theksohet se Sekretari nuk i plotëson kushtet në lidhje me shkallë e arsimit/EKTC kreditë të ciltë kërkohen për vendin e punës së lëndës, dhe rrejdhimisht nga ajo udhëzohet në paligjësi gjatë përcaktimit dhe llogaritje së rrogës nga aspekti i koeficientit për llogaritje të rrogës dhe në lartësinë e rrogës e cila personit të përmendur i paguhet duke llogaritur nga viti kur është emëruar si Sekretar në këtë dhe më tej.

Në denoncim flitet, gjithashtu, se personi i cili është emëruar për Sekretar në nga viti, në mënyra të ndryshme e ka kqepërdorur pozitën zyrtare dhe autorizimin – me kryerjen e mobingut, me zhvillimin e procedurave disiplinore em tendencë, me nënshkrimin e vendimeve për suspendim, vendime për ndërprerje të kontratave për punësim, etj.

Gjatë veprimit për lëndën e denoncuar, Komisioni shtetëror përparandalim të korrupsionit duke u nisur nga akuzat e parashtruesit, me qëllim të përcaktimit të gjendjes së plotë faktike bëri kontrollime adekuate administrative në lidhje me besueshmërinë e tyre dhe

bazēn nē mēnyrē qē tē ndērmerr veprime procesive – dorēzimi kērkēsēs pēr mblēdhje tē tē dhēnave dhe informacioneve – me shtojcē dokumentacion, deri te, gjegjēsisht deri tek organi pēr menaxhim me kētē

Rrjedhimisht, me arsyje tē kērkēsave tē dorēzuara, deri tek Komisioni shtetēror pēr parandalim tē korrupsionit ēshtē dorēzuar pērgjigje me shkrim me shtojcē dokumentacion – diplomē, vērtetim pēr pērfundim tē ciklit tē dytē tē studimeve, vērtetim pēr njohje tē gjuhēs sē huaj, vendimi pēr rrogē, listē shqyrtuese – kartelē pēr pagesē tē rrogēs dhe kopje nga akti i sistematizimit nē

Nga tē gjitha shkrimet nē dispozicion dhe dokumentat pēr kētē rast tē denoncuar Komisioni shtetēror konstaton se akuzat nē rastin e denoncuar nuk janē vērtetuar, gjegjēsish se personi i pērmendur nē ditēn e emērimt nē vendin e punēs Sekretar ka tē fituar; nē vitin, kredi EKTC nga cikli i parē i studimeve, kurse nē mēnyrē plotēsues ka tē fitues edhe kredi EKTC nga cikli i dytē i studimeve nga, me çka nuk janē vērtetuar edhe akuzat tjera nga denoncimi tē cilēt kanē tē bējnē me pagesēn joligjore tē rrogēs sipas mēnyrēs sē arsimit adekuat.

Nē bazē tē tē gjitha rrethanave tē rastit tē lēndēs sē denoncuar dhe pas analizimit tē plotē tē tē gjitha shkrimeve – Komisioni shtetēror pēr parandalim tē korrupsionit vlerēson se akuzat nē denoncim nuk tregojnē pēr korrupsion – punē jo tē kujdesshme dhe/ose keqpērdorim tē funksionit, autorizimit publik, detyrēs zyrtare ose pozitēs pēr realizimin e interesave, drejtpērdrejtē ose me ndērmjetēsues, pēr vete ose pēr tjetēr nga ana e personave zyrtar nē rastin konkret, tē cilēt mund tē ngriten nē bazē tē dyshimit pēr vepra penale tē kryera nga Krei i tredhjetē – Vepra penale kundēr detyrēs zyrtare nga Kodi penal i Republikēs sē Maqedonisē sē Veriut.

Nē bazē tē tē gjithē tē sipērshēnuarēs, Komisioni shtetēror pēr parandalim tē korrupsionit vendosi sipas dispozitave tē kētij vendimi.

Ky vendim ēshtē i prerē dhe kundēr kētij nuk ēshtē e lejuar ankesa.

Ēshtē vendosur me datē 19 shkurt 2021 me numēr/.....

**KOMISIONI SHTETĒROР ПЉР
PARANDALIM TĒ KORRUPTIONIT
Zēvendēs-Kryetarē: m-r Shemshi Sallai**

Pas pērfundimit tē KSHPK
Pērpunoi: H. M., kēshilltarē
Miratoi: m-r Shemshi Sallai, anētar i KSHPK
Dorēzuar deri tek: Arkiva